



REPUBLIKA E SHqipëRIE  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DHE EKONOMISE

**NËNTOR 2021**

**EKONOMIA DHE BUXHETI**

Raport Mujor

# EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Nëntor 2021

© Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2021  
Drejtoria e Analizave Makroekonomike dhe Statistikave  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë

[www.financa.gov.al](http://www.financa.gov.al)

**E-mail:** [Juli.Lubonja@financa.gov.al](mailto:Juli.Lubonja@financa.gov.al)

# Përmbajtja

**VEÇORITË KRYESORE** \_\_\_\_\_ **2**

**ZHVILLIMET EKONOMIKE** \_\_\_\_\_ **3**

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit \_\_\_\_\_ 3
2. Kursi mesatar i Këmbimit \_\_\_\_\_ 4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave \_\_\_\_\_ 5
4. Bilanci i Pagesave \_\_\_\_\_ 6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar \_\_\_\_\_ 7
6. Kredia për Ekonominë \_\_\_\_\_ 8
7. Oferta e Parasë \_\_\_\_\_ 9
8. Depozitat sipas burimeve \_\_\_\_\_ 10

**SEKTORI FISKAL** \_\_\_\_\_ **11**

1. Buxheti i Konsoliduar \_\_\_\_\_ 11
2. Të Ardhurat Sipas Burimeve \_\_\_\_\_ 12
3. Financimi i Bilancit Fiskal \_\_\_\_\_ 13

**ANEKSI STATISTIKOR** \_\_\_\_\_ **13**

# Veçoritë Kryesore


- Indeksi i çmimeve të konsumit në muajin Nëntor 2021, arriti në 102.8;
- Norma vjetore e inflacionit për muajin Nëntor 2021 ishte 3.1 përqind;
- Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin Nëntor 2021 ishte 106.91 lekë për dollarë dhe 122.13 lekë për euro;
- Normat e interesit të depozitave në lekë gjatë muajit Nëntor 2021 shënuan kuotën 0.46 përqind për ato 12-mujore; 0.39 përqind për depozitat 6-mujore; 0.12 përqind për depozitat 3-mujore dhe 0.43 përqind për depozitat 1-mujore;
- Normat e interesit për huatë në lekë ishin 5.65 përqind për huatë 12-mujore dhe 6.61 përqind për ato 6-mujore;
- Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1.545.844 milionë lekë në muajin Nëntor, duke shënuar një rritje prej rreth 8.9 përqind, krahasuar me një vit më parë;
- Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e tretë të 2021 rezultoi me rritje të mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën 271.57 milionë euro.
- Situata Buxhetore për periudhën Janar - Nëntor 2021 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej rreth -32.98 miliardë lekë, ndërkohë që ishte planifikuar një deficit prej -104.76 miliardë lekë.
- Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar - Nëntor 2021, arritën në rreth 458.38 miliardë lekë ose afërsisht 3.5% më shumë se plani për këtë periudhë.
- Shpenzimet gjithsej gjatë së njëjtës periudhë, arritën në rreth 491.37 miliardë lekë ose rreth 10.3% më pak se shpenzimet e planifikuara për këtë periudhë.

# Zhvillimet Ekonomike

## 1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin Nëntor 2021 ishte 3.1%, një vit më parë ky ndryshim ishte 1.6%. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Nëntor 2021, krahasuar me Tetor 2021 është 0.2%. Një muaj më parë, Tetor 2021, IÇK shënoi rritje mujore prej 0.1%.

Referuar një viti më parë, Indeksi i Çmimeve të Konsumit për muajin Nëntor 2020 shënoi rënie mujore prej 0.5%, në krahasim me muajin paraardhës.



Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, grupet të cilat patën kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm ishin:

- “Ushqime dhe pije joalkolike” me rritje vjetore të çmimit prej +5%, duke kontribuar me +1.77 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +3.1%.
- “Transport” me rritje vjetore të çmimit prej +8.8%, duke kontribuar me +0.47 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +3.1%.

- “Komunikim”, me rritje vjetore +3.2%, duke kontribuar me +0.1 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +3.1%.
- “Hotele, kafene dhe restorante” ka pësuar rritje vjetore të çmimit prej +2.4%, duke kontribuar me +0.1 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +3.1%.
- “Pije alkolike dhe duhan” me rritje vjetore të çmimit prej +1.6%, duke kontribuar me +0.06 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm prej +3.1%.

**Tab - 1** Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)


VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
<b>2020</b>	1.5	1.2	2.1	1.9	2.1	1.8	1.4	1.3	1.5	2.0	<b>1.6</b>	1.1
<b>2021</b>	0.4	1.1	1.2	1.9	1.8	1.6	2.2	2.4	2.5	2.4	<b>3.1</b>	-

Burimi: INSTAT

## 2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin Nëntor 2021, arriti në 122.13 lekë/euro, duke shënuar rritje në vlerë me 0.34 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Nëntor, një euro u këmbye me 121.19 lekë.

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Nëntor 2021 arriti në 106.91 lekë/dollarë duke shënuar rritje në vlerë me 1.88 përqind kundrejt një muaji më parë. Në fund të muajit Nëntor, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 107.49 lekë/dollarë.



Në krahasim me muajin Nëntor të vitit të kaluar, pas një periudhe të konsiderueshme forcimi, rezulton se monedha shqiptare ka pësuar një mbiçmim ndaj monedhës europiane në masën 1.33 përqind, ndërsa kundrejt dollarit amerikan rezulton se është nënçmohet në masën 2.11 përqind. Në pëgjithësi, dobësimi i lekut në vitin e fundit ka ardhur si pasojë e një rënie relative të ekonomisë në vend, për shkak të dy goditjeve të njëpasnjëshme, tërmetit të ndodhur në dhjetor 2019 dhe situatës së krijuar nga pandemia botërore Covid-19.

Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, shënoi një nivel mesatar rreth 0.88 dollarë/euro për muajin Nëntor 2021.

Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë kësaj periudhe përmendim: qendrueshmëria e kursit të këmbimit për shkak të ndërhyrjes së shpejtë të BSH-së, stabiliteti i situatës makroekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasiteti në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga BSH-ja, etj.

### 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit Nëntor 2021, normat e interesit të depozitave me afat 12 dhe 1 muajore shënuan vlerat më të larta prej 0.46 dhe 0.43 përqind përkatësisht, pasuar nga ato me afat 6 dhe 3 muajore që arritën kuotën 0.39 dhe 0.12 përqind përkatësisht.

Krahasuar me një muaj më parë, normat e interesit të depozitave me afat maturimi 12 dhe 3 muajore kanë shënuar rënie mujore prej përkatësisht 0.01 dhe 0.03 pikë përqindje. Ndërsa normat e interesit të depozitave me afat 6 dhe 1 muajore shënuan rritje mujore respektivisht me 0.1 dhe 0.02 pikë përqindje.


Referuar një viti më parë, normat e interesit të depozitave me afat maturimi 12 dhe 6 muajore kanë shënuar rritje

vjetore përkatësisht prej 0.06 dhe 0.09 pikë përqindje. Ndërsa, normat e interesit të depozitave me afat 1 muajore nuk patën ndryshime krahasuar me një vit më parë.

Normat e Interesit të huave 6 dhe 12 muajore, gjatë muajit Nëntor 2021, arritën përkatësisht kuotën prej 6.61 dhe 5.65 përqind. Në krahasim me një muaj më parë, normat e interesit të huave 12 muajore kanë shënuar rënie me 0.23 pikë përqindje. Nërsa, ato 6 muajore kanë shënuar rritje me 0.57 pikë përqindje. Krahasuar me një vit më parë normat e interesit të huave 6 dhe 12 muajore kanë shënuar rritje vjetore përkatësisht me 0.62 dhe 0.28 pikë përqindje.

Normat e interesit të bonove të thesarit 12 muajore për muajin Nëntor 2021 patën rënie mujore dhe vjetore përkatësisht me 0.01 dhe 0.08 pikë përqindje.


Fig. 3



Normat e interesit për depozitat (%)

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-4





Normat e interesit për huatë dhe bonot

Burimi: Banka e Shqipërisë


## 4. Bilanci i Pagesave

Në tremujorin e tretë të vitit 2021, bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi pozitiv në rritje të mjeteve valutore (rezervës) prej rreth 252.37 milionë euro. Për nëntëmujorin e parë të vitit 2021, defiçiti i llogarisë korente u ngushtua në -670.1 milion euro krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë që ishte -803.8 milion euro. Po ashtu, vetëm për tremujorin e tretë të 2021, llogaria korente e ngushtoi deficitin në -116.6 milion euro, krahasuar me tremujorin e tretë të 2020 që ishte -191.1 milion euro. Në nëntëmujorin e parë të vitit 2021, Llogaria financiare dhe kapitale u ngushtua në vlerën +703.2 milion euro krahasuar me +1,542.4 miliardë euro në nëntëmujorin e parë të 2020. Ndërsa, vetëm për tremujorin e tretë të 2021, llogaria financiare dhe kapitale u zgjerua në +231.9 mln euro, krahasuar me +135.3 mln euro në tremujorin e tretë të 2020. Në nëntëmujorin e parë të vitit 2021, Investimet e huaja direkte shënuan vlerën +735.8 milionë euro ose +0.7%, krahasuar me +730.6 milion euro në nëntëmujorin e parë të 2020. Ndërsa vetëm për tremujorin e tretë të 2021, IHD regjistruan vlerën +258.3 mln euro ose +8.0%, krahasuar me +239.2 mln euro në tremujorin e tretë të 2020. Në nëntëmujorin e parë të vitit 2021, të hyrat nga shërbimet të lidhura përgjithësisht me Turizmin u zgjeruan në vlerën +1,473.7 miliardë euro, +101.4% (ose rreth 2 herë më shumë), krahasuar me +731.7 milion euro në nëntëmujorin e parë të 2020. Gjithashtu, vetëm për tremujorin e tretë të 2021, ky zë regjistroi vlerën +786.5 mln euro, ose rreth 2.4 herë më shumë krahasuar me +323.2 mln euro në tremujorin e tretë të 2020.




## 5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit Nëntor 2021, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 122.608 milionë lekë krahasuar me muajin Nëntor të vitit 2020. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të Bankës Qëndrore me 106.929 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë mjetet valutore neto kanë shënuar rritje me 63 566 milionë lekë, ku më së shumti ka kontribuar rritja mujore prej 87.166 milionë lekë e Bankës Qëndrore.



Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në rreth 1,545.844 milionë lekë në muajin Nëntor 2021, duke shënuar një rritje prej rreth 126.570 milionë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, pra një rritje vjetore prej 8.9 përqind.

Gjithashtu në muajin Nëntor 2021, sistemi bankar rezulton me rënie mujore prej 6,703 milionë lekë ose 0.43 përqind në mjetet valutore neto krahasuar me muajin paraardhës.





## 6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin Nëntor 2021 arriti në rreth 658.511 milionë lekë. Bilanci i kredisë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shënoi rritje me vlerë 62.682 milionë lekë, ose rritje me rreth 10.5 përqind. Struktura e kredisë sipas monedhave është e balancuar mes monedhës kombëtare (52.8%) dhe monedhave të huaja (47.2%).

Gjatë muajit Nëntor 2021, zëri “Korporata të tjera jo-financiare”, zuri peshën më të lartë të totalit të kredive, me rreth 60.1 përqind ose 396.070 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 35.27 përqind ose rreth 232.228 milionë lekë. Zërat “Korporata jo financiare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 2.5 dhe 2.04 përqind apo 16.449 dhe 13.437 milionë lekë.


Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës së huaj për muajin Nëntor 2021, zëri “Korporata të tjera jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 71.53 përqind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 24.18 përqind. “Korporata të tjera financiare” dhe “Korporata jofinanciare publike” kontribuojnë përkatësisht me 2.06 dhe 2.23 përqind secili.



## 7. Oferta e Parasë

Paraja jashtë Korporatave Depozituese arriti në rreth 359.902 milionë lekë në fund të muajit Nëntor 2021. Raporti i Parasë jashtë Bankave me M3 në Nëntor 2021 ka shënuar rritje mujore prej 0.22 përqind dhe rënie vjetore prej 0.32 përqind, duke arritur nivelin 23.28 përqind. Raporti i Parasë jashtë Bankave me Depozitat ka shënuar rritje mujore prej 0.38 përqind, dhe rënie vjetore prej 0.54 përqind, duke shënuar nivelin 30.3 përqind.


Fig-11



**Raportet e parasë jashtë bankave me M3 & Depozitat**  
Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në valutë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin Nëntor 2021, kanë shënuar rritje vjetore prej 71.403 milionë lekë, e sjellë kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 76.9 përqind të depozitave në valutë. Gjithashtu depozitat në Lekë gjatë muajit Nëntor 2021 shënuan rritje prej 30.203 milionë lekë në krahasim me muajin Nëntor 2020. Sektori i Individëve në lekë ka zënë rreth 80.6 përqind të tyre.

Fig-12




**Raporti i Depozitave ndaj M3**  
Burimi: Banka e Shqipërisë

## 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Nëntor 2021, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 80.6 përqind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 14.5 përqind dhe nga “Korporata jo-financiare publike” me 3.0 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 76.9 përqind dhe rreth 20.0 përqind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 78.5 përqind e totalit.

Fig-13




Rritja e stokut total të depozitave

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 932,571 milionë lekë të depozitave totale. Ato ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (208.612 milionë lekë), “Korporata të tjera financiare” (24.610 milionë lekë), dhe “Korporata jofinanciare publike” (20.002 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth (1.468 milionë lekë) në totalin e depozitave. Gjatë muajit Nëntor 2021, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën rreth 1.187.263 milionë lekë.

Fig-14



Përberja e depozitave Nëntor '21


Burimi: Banka e Shqipërisë

Krahasuar me një muaj më parë niveli i depozitave shënoi rënie prej rreth 8.613 milionë lekë, gjithashtu krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar rritje me 101.606 milionë lekë.

# Sektori Fiskal

## 1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën Janar - Nëntor 2021 janë mbledhur rreth 458.383 miliardë lekë të ardhura, përkundëjt shpenzimeve të përgjithshme prej 491.366 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 404.502 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe rreth 86.203 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat rreth 46.99% janë financime të brëndshme.



Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 302.811 miliardë lekë. Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor janë rreth 24.970 miliardë lekë (ose rreth 6.4% më shumë se plani i periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 101.521 miliardë lekë (ose rreth 8.5% më shumë se plani i periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 19.648 miliardë lekë (ose rreth 2.5% më pak se plani për periudhën Janar-Nëntor 2021).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 404.502 miliardë lekë, 75.519 miliardë lekë (18.7% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 34.447 miliardë lekë (8.5%) për shpenzime interesi, 45.983 miliardë leke (11.4%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 924 miliardë lekë (0.23%) për subvencione, 176.699 miliardë lekë (43.68%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, 45.475 miliardë lekë (11.24%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, dhe 25.455 miliardë lekë (6.29%) për shpenzimet e tjera.

## 2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar - Nëntor 2021 ishin rreth 458.383 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 429.302 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 19.648 miliardë lekë.

Tab - 2	Të ardhurat gjatë muajit Janar - Nëntor 2021 (mld Lekë) Revenues during January - November 2021 (in billion ALL)			
	Burimi (Source)	Nëntor '21 Nov '21	Nëntor '20 Nov '20	Ndrysh(% Chang (%)
	TVSH (VAT)	144.274	117.555	+22.7
	Taksa doganore (Custom Tax)	6.701	5.503	+21.8
	Akcizat (Excise)	46.608	40.109	+16.2
	Tatimi mbi fitimin (Profit Tax)	30.670	24.813	+23.6
	Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax)	36.074	30.906	+16.7
	Taksat nacionale (National Tax)	38.484	31.988	+20.3

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Statistikat Fiskale: Nëntor - 2021

Source: Ministry of Finance and Economy, Fiscal Statistics: November - 2021

## 3. Financimi i Bilancit Fiskal

Deficiti prej 32.983 miliardë lekë gjatë periudhës Janar-Nëntor 2021, u financua kryesisht nga financimi i jashtëm.

Për periudhën Janar-Nëntor 2021, disa nga treguesit kryesorë fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 458.383 miliardë lekë,
- Realizimi i shpenzimeve në masën 491.366 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për periudhën Janar - Nëntor 2021, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat tatimore, të cilat arrijnë shifrën e 429.302 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 404.502 miliardë lekë dhe shpenzimet për fonde speciale me rreth 176.699 miliardë lekë.

# Aneksi Statistikor

**Tab - 1** Indeksi i çmimeve të konsumit  
Consumer price index (in %)

Muaji	Mujor (Monthly)						Mesatar Mujor (Monthly Average)						Vjetor (Annual)						Month
	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2016	2017	2018	2019	2020	2021	
Janar	0.9	1.5	1.5	1.6	1.9	1.3	0.9	1.5	1.5	1.6	1.9	1.3	1.5	2.8	1.7	1.9	1.5	0.4	January
Shkurt	1.1	0.5	0.8	0.6	0.4	1.1	1.0	1.0	1.1	1.1	1.1	1.2	0.2	2.2	2.1	1.7	1.2	1.1	February
Mars	0.5	0.4	0.3	-0.3	0.6	0.7	0.8	0.8	0.9	0.6	0.9	1.0	0.3	2.1	2.0	1.1	2.1	1.2	March
Prill	-0.4	-0.6	-0.5	-0.2	-0.4	0.2	0.5	0.5	0.5	0.4	0.6	0.8	0.3	1.9	2.1	1.4	1.9	1.9	April
Maj	-1.2	-1.2	-1.2	-1.0	-0.8	-0.9	0.2	0.1	0.2	0.1	0.3	0.5	0.7	2.0	2.1	1.5	2.1	1.8	May
Qershor	-0.6	-0.4	-0.1	-0.3	-0.6	-0.8	0.04	0.0	0.1	0.1	0.2	0.3	1.2	2.2	2.4	1.3	1.8	1.6	June
Korrik	0.0	-0.1	-0.3	-0.1	-0.5	0.1	0.04	0.0	0.1	0.0	0.1	0.2	1.9	2.0	2.3	1.5	1.4	2.2	July
Gusht	0.9	0.4	0.4	0.3	0.2	0.4	0.14	0.1	0.1	0.1	0.1	0.3	2.0	1.6	2.2	1.5	1.3	2.4	August
Shtator	0.4	0.4	0.2	0.1	0.4	0.5	0.17	0.1	0.1	0.1	0.1	0.3	1.8	1.6	2.1	1.3	1.5	2.5	September
Tetor	-0.2	0.0	-0.2	-0.2	0.2	0.1	0.04	-0.1	-0.1	-0.1	0.1	0.3	1.8	1.6	2.1	1.3	2.0	2.4	October
Nëntor	0.1	-0.1	-0.2	-0.2	-0.5	<b>0.2</b>	0.12	0.1	0.1	0.0	0.1	<b>0.3</b>	1.9	1.7	1.8	1.4	1.6	<b>3.1</b>	November
Dhjetor	0.1	-0.1	-0.2	-0.2	0.3		0.05	-0.1	-0.1	-0.1	0.1		1.9	1.7	1.8	1.4	1.1		December

Burimi : INSTAT

Source : INSTAT

Tab - 2 **Kursi i këmbimit**  
Exchange rate

Monedha	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021											Currency	
							Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht August	Shtator September	Tetor October	Nëntor November		
<b>Mesatarja e perludhës</b>																			<i>Average of period</i>
USD	125.96	124.15	119.10	107.99	109.85	108.65	101.61	102.22	103.61	102.89	101.24	101.93	103.43	103.28	103.32	104.94	106.91	USD	
EURO	139.74	137.36	134.15	127.59	123.01	123.77	123.53	123.61	123.34	123.10	123.01	122.83	122.32	121.55	121.59	121.71	122.13	EURO	
<b>Fundi i perludhës</b>																			<i>In the end of period</i>
USD	125.79	128.17	111.10	107.82	108.64	100.84	101.97	101.99	104.91	101.89	100.96	103.10	102.32	103.14	104.79	105.47	107.49	USD	
EURO	137.28	135.23	132.95	123.42	121.77	123.70	123.61	123.67	123.16	123.19	123.05	122.67	121.80	121.95	121.54	122.84	121.19	EURO	

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

**Tab - 3** **Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)**  
Annual Interest Rates (in ALL)

Në përqindje	2018	2019	2020	2021												In percent
				Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht August	Shtator September	Tetor October	Nëntor November		
<b>Norma e depozitave</b>																<b>Deposits rates</b>
12-M	0.73	0.49	0.41	0.47	0.63	0.45	0.47	0.52	0.49	0.48	0.36	0.46	0.47	0.46	0.46	12-M
6-M	0.59	0.42	0.35	0.32	0.29	0.34	0.30	0.40	0.29	0.24	0.26	0.60	0.29	0.39	0.39	6-M
3-M	0.28	0.23	0.21	0.15	0.15	0.16	0.17	0.15	0.16	0.16	0.13	0.17	0.15	0.12	0.12	3-M
1-M	0.76	0.66	0.49	0.41	0.40	0.40	0.42	0.38	0.40	0.42	0.43	0.40	0.41	0.43	0.43	1-M
<b>Norma e huasë</b>																<b>Lending rates</b>
12-M	5.66	6.25	6.05	6.85	6.56	5.35	6.34	5.79	5.89	6.50	5.83	5.69	5.88	5.65	5.65	12-M
6-M	8.12	7.07	6.28	5.56	5.39	5.84	5.94	6.12	5.76	6.75	7.03	6.48	6.04	6.61	6.61	6-M
<b>Norma e letrave me vlerë</b>																<b>Securities rates</b>
Bono thesari 1/																Treasury bills 1/
3-M	-	-	-	1.09	1.29	1.37	1.37	0.89	0.96	0.99	0.87	0.93	1.00	0.82	0.82	3-M
6-M	-	-	-	-	1.58	1.76	-	1.25	-	-	1.22	1.34	-	1.31	1.31	6-M
12-M	1.43	1.69	1.77	1.92	2.06	2.13	1.83	1.67	1.49	1.48	1.73	1.77	1.70	1.69	1.69	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

## TREGUESIT FISKAL SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2021

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2021

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

Nr.	E M E R T I M I	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht August	Shtator Sep	Tetor Oct	Nëntor Nov	ITEMS
	<b>TOTALI TË ARDHURAVE</b>	<b>35,215</b>	<b>69,540</b>	<b>109,350</b>	<b>153,008</b>	<b>191,491</b>	<b>234,320</b>	<b>281,805</b>	<b>324,226</b>	<b>367,736</b>	<b>413,726</b>	<b>458,383</b>	<b>TOTAL REVENUE</b>
I.	<b>Të ardhura nga ndihmat</b>	<b>108</b>	<b>331</b>	<b>1,087</b>	<b>2,653</b>	<b>2,711</b>	<b>3,846</b>	<b>6,284</b>	<b>6,495</b>	<b>7,538</b>	<b>7,983</b>	<b>9,433</b>	<b>Grands</b>
II.	<b>Të ardhura tatimore</b>	<b>33,908</b>	<b>66,871</b>	<b>103,982</b>	<b>142,401</b>	<b>179,308</b>	<b>219,009</b>	<b>262,472</b>	<b>303,112</b>	<b>343,792</b>	<b>387,561</b>	<b>429,302</b>	<b>Tax Revenue</b>
II.1	<b>Nga Tatimet dhe Doganat</b>	<b>23,093</b>	<b>46,219</b>	<b>72,778</b>	<b>97,598</b>	<b>123,217</b>	<b>151,111</b>	<b>181,461</b>	<b>211,340</b>	<b>240,490</b>	<b>271,556</b>	<b>302,811</b>	<b>From tax offices and customs</b>
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	11,205	21,627	31,730	43,046	55,237	68,406	83,922	97,590	111,277	127,577	144,274	V.A.T
2	Tatimi mbi Fitimin	1,553	3,713	10,579	12,994	15,134	17,653	19,624	21,660	24,799	27,331	30,670	Profit Tax
3	Akcizat	3,185	6,607	10,346	14,049	18,293	23,176	27,996	33,398	37,904	42,361	46,608	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	3,382	6,493	9,304	12,905	16,004	19,120	22,832	27,205	30,164	33,197	36,074	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	3,394	6,842	9,312	12,533	15,875	19,434	23,049	26,773	30,980	35,044	38,484	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	375	938	1,506	2,071	2,675	3,322	4,038	4,714	5,367	6,045	6,701	Customs Duties
II.2	<b>Të ardhura nga Pushteti Vendor</b>	<b>1,344</b>	<b>2,836</b>	<b>4,920</b>	<b>8,295</b>	<b>10,961</b>	<b>13,966</b>	<b>16,578</b>	<b>18,410</b>	<b>21,093</b>	<b>23,267</b>	<b>24,970</b>	<b>Revenues from Local Gov.</b>
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	283	572	977	1,988	2,789	3,566	4,027	4,475	4,928	5,331	5,666	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	2	10	83	255	278	292	334	345	353	359	374	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	1,060	2,254	3,860	6,051	7,894	10,108	12,217	13,591	15,811	17,577	18,929	Local Taxes
II.3	<b>Të ardh nga fondet speciale</b>	<b>9,470</b>	<b>17,816</b>	<b>26,284</b>	<b>36,508</b>	<b>45,130</b>	<b>53,932</b>	<b>64,433</b>	<b>73,361</b>	<b>82,208</b>	<b>92,738</b>	<b>101,521</b>	<b>Social Ins. contributions</b>
1	Sigurimi Shoqëror	8,127	15,285	22,587	31,251	38,576	46,155	55,095	62,805	70,402	79,376	86,908	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetsor	1,333	2,387	3,457	4,868	5,965	7,075	8,517	9,638	10,798	12,251	13,375	Health insurance
3	Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve	11	144	240	389	589	701	821	919	1,009	1,112	1,238	Compensation income in the value of owners
III.	<b>Të ardhura Jotatimore</b>	<b>1,200</b>	<b>2,339</b>	<b>4,281</b>	<b>7,954</b>	<b>9,472</b>	<b>11,465</b>	<b>13,049</b>	<b>14,619</b>	<b>16,406</b>	<b>18,182</b>	<b>19,648</b>	<b>Nontax Revenue</b>
1	Tran,Fitimi nga Banka e Shqipërisë				1,486	1,486	1,486	1,486	1,486	1,486	1,486	1,486	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	748	1,511	2,740	4,404	5,301	6,627	7,571	8,528	9,619	10,467	11,295	Income of budgetary institutions
3	Tarifat shërbimeve	193	323	676	869	1,024	1,270	1,530	1,788	2,045	2,290	2,494	Utility fees
4	Të tjera	259	505	861	1,191	1,658	2,078	2,458	2,813	3,251	3,935	4,368	Others
	<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>	<b>33,208</b>	<b>70,042</b>	<b>118,167</b>	<b>167,849</b>	<b>212,160</b>	<b>263,461</b>	<b>311,561</b>	<b>355,284</b>	<b>403,729</b>	<b>449,631</b>	<b>491,366</b>	<b>TOTAL EXPENDITURE</b>
I.	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>31,127</b>	<b>63,237</b>	<b>101,632</b>	<b>140,000</b>	<b>175,247</b>	<b>216,421</b>	<b>257,278</b>	<b>295,326</b>	<b>331,147</b>	<b>369,855</b>	<b>404,502</b>	<b>Current Expenditures</b>
I.1	<b>Personeli</b>	<b>6,421</b>	<b>13,212</b>	<b>20,188</b>	<b>27,300</b>	<b>34,188</b>	<b>41,391</b>	<b>48,562</b>	<b>55,237</b>	<b>61,926</b>	<b>68,617</b>	<b>75,519</b>	<b>Personnel expenditures</b>
1	Paga	5,510	11,326	17,312	23,426	29,312	35,496	41,564	47,231	52,963	58,663	64,530	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	904	1,855	2,825	3,801	4,778	5,760	6,733	7,660	8,583	9,494	10,439	Social insurance contributions
3	Arsimi I larte nga te ardhurat e veta	6	31	50	73	97	134	265	346	380	461	550	Higher education from its own income
I.2	<b>Interesat</b>	<b>4,547</b>	<b>6,922</b>	<b>9,660</b>	<b>12,320</b>	<b>13,948</b>	<b>18,325</b>	<b>23,077</b>	<b>25,377</b>	<b>28,366</b>	<b>32,932</b>	<b>34,447</b>	<b>Interest</b>
1	Të Brendshme	3,509	5,304	7,497	9,598	10,657	11,785	15,523	17,273	19,713	21,634	22,844	Domestic
2	Të Huaja	1,038	1,618	2,163	2,721	3,291	6,540	7,554	8,104	8,653	11,297	11,963	Foreign
I.3	<b>Shpenzime Operative Mirëmbajtje</b>	<b>2,366</b>	<b>5,440</b>	<b>10,486</b>	<b>15,505</b>	<b>20,194</b>	<b>25,263</b>	<b>29,592</b>	<b>33,192</b>	<b>36,475</b>	<b>41,046</b>	<b>45,983</b>	<b>Operational &amp; Maintenance</b>
I.4	<b>Subveconet</b>	<b>88</b>	<b>177</b>	<b>255</b>	<b>334</b>	<b>415</b>	<b>500</b>	<b>618</b>	<b>709</b>	<b>786</b>	<b>838</b>	<b>924</b>	<b>Subsidies</b>
I.5	<b>Shpenzime për fonde speciale</b>	<b>13,738</b>	<b>27,152</b>	<b>43,662</b>	<b>59,910</b>	<b>74,991</b>	<b>92,403</b>	<b>110,198</b>	<b>129,283</b>	<b>145,767</b>	<b>161,788</b>	<b>176,699</b>	<b>Social insurance outlays</b>
1	Sigurime Shoqërore	10,493	20,812	31,480	42,610	53,932	66,772	80,890	95,479	108,303	119,988	131,140	Social insurance
2	Sigurime Shëndetsore	2,632	5,453	11,000	15,876	19,635	24,092	27,769	32,139	35,798	40,134	43,893	Health insurance
3	Fondi i kompensimit të pronarëve	613	887	1,182	1,424	1,424	1,538	1,538	1,665	1,666	1,666	1,666	Owners' Compensation Fund
I.6	<b>Shpenzime per Buxhetin Vendor</b>	<b>2,466</b>	<b>6,530</b>	<b>10,762</b>	<b>15,458</b>	<b>19,810</b>	<b>24,333</b>	<b>28,486</b>	<b>32,485</b>	<b>36,556</b>	<b>41,141</b>	<b>45,475</b>	<b>Local budget expenditure</b>
I.7	<b>Shpenzime të tjera</b>	<b>1,503</b>	<b>3,803</b>	<b>6,619</b>	<b>9,173</b>	<b>11,701</b>	<b>14,207</b>	<b>16,745</b>	<b>19,043</b>	<b>21,270</b>	<b>23,492</b>	<b>25,455</b>	<b>Other expenditures</b>
1	Pagesa e Papunesisë	84	175	281	386	482	566	638	710	776	843	895	Unemployment insurance benefits
2	Ndihma Ekonomike	1,219	3,176	5,493	7,628	9,700	11,859	13,940	15,667	17,420	19,193	20,870	Economic Aid
3	Bonusi I lindjeve	200	400	700	900	1,200	1,400	1,700	2,200	2,500	2,800	3,000	Birth bonus
I.8	<b>Transferime Kapitale</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>200</b>	<b>200</b>	<b>200</b>	<b>200</b>	<b>Capital transfers</b>
II	<b>Fondi Rezerve, Kontigjenca</b>	<b>92</b>	<b>137</b>	<b>189</b>	<b>240</b>	<b>288</b>	<b>337</b>	<b>384</b>	<b>432</b>	<b>432</b>	<b>461</b>	<b>461</b>	<b>Reserve fund/contingency</b>
III	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>1,983</b>	<b>5,761</b>	<b>13,391</b>	<b>27,609</b>	<b>36,625</b>	<b>46,703</b>	<b>53,698</b>	<b>59,326</b>	<b>71,951</b>	<b>79,115</b>	<b>86,203</b>	<b>Capital expenditures</b>
1	Financimi Brendshëm		2,756	7,656	13,373	18,855	24,117	26,939	29,441	33,989	37,605	40,511	Domestically financing
2	Investime nga te ardhurat e Arsimit te Larte		39	64	167	224	349	391	444	548	570	629	From higher education system's own revenues
3	Financimi Huaj	1,983	2,966	5,670	7,164	8,377	11,385	12,587	13,731	17,427	18,901	21,902	Foreign financed
IV	<b>Fondi I rindertimit</b>	<b>6</b>	<b>907</b>	<b>2,955</b>	<b>6,904</b>	<b>9,169</b>	<b>10,851</b>	<b>13,781</b>	<b>15,711</b>	<b>19,987</b>	<b>22,039</b>	<b>23,161</b>	<b>Reconstruction fund</b>
V.	<b>DEFICITI</b>	<b>2,007</b>	<b>-502</b>	<b>-8,817</b>	<b>-14,841</b>	<b>-20,668</b>	<b>-29,141</b>	<b>-29,756</b>	<b>-31,059</b>	<b>-35,994</b>	<b>-35,905</b>	<b>-32,983</b>	<b>CASH BALANCE</b>
V.1	<b>FINANCIMI DEFICITIT</b>	<b>-2,007</b>	<b>502</b>	<b>8,817</b>	<b>14,841</b>	<b>20,668</b>	<b>29,141</b>	<b>29,756</b>	<b>31,059</b>	<b>35,994</b>	<b>35,905</b>	<b>32,983</b>	<b>CASH BALANCE FINANCING</b>
V.2	<b>Brendshëm</b>	<b>-2,780</b>	<b>1,599</b>	<b>-9,057</b>	<b>-1,971</b>	<b>8,488</b>	<b>18,435</b>	<b>19,906</b>	<b>23,785</b>	<b>28,587</b>	<b>17,968</b>	<b>-72,398</b>	<b>Domestic</b>
1	Të ardhura nga privatizimi	17	20	25	33	35	104	107	111	115	117	282	Privatization receipts
2	Hua-marje e brendshme	7,460	9,527	17,298	20,331	24,684	31,986	36,224	38,057	45,628	49,176	51,166	Domestic new borrowing (net)
3	Të tjera	-10,257	-7,948	-26,379	-18,393	-16,231	-13,655	-16,425	-14,383	-17,157	-31,324	-123,845	Others
V.3	<b>I huaj</b>	<b>773</b>	<b>-1,098</b>	<b>17,874</b>	<b>12,870</b>	<b>12,181</b>	<b>10,706</b>	<b>9,850</b>	<b>7,274</b>	<b>7,407</b>	<b>17,937</b>	<b>105,381</b>	<b>Foreign</b>
1	Hua afatgjatë(e marrë)	1,665	2,560	4,397	6,144	5,439	8,457	9,649	10,490	11,952	12,035	91,797	Long-term foreign borrowing (gross)
2	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	352	222	366	-745	-13,872	-17,267	-379	-278	981	2,000	1,055	Chang. of stat. Account
3	Ripagesat	-1,245	-3,880	-6,279	-11,919	-1,224	127	-18,810	-22,328	-24,916	-27,630	-30,012	Repayments
4	Mbështetje Buxhetore			19,390	19,390	19,390	19,390	19,390	19,390	19,390	31,532	42,541	Budgetary Support

Burimi : Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Source : Ministry of Finance and Economy

\* Ndryshimi i gjendjes së arkës\* përfaqëson ndryshimin e Depozitës së Financimeve të Huaja

## Tabela e investimeve 2021

Table of investments 2021

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë ( in million ALL)

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	
	January	February	March	April	May	June	July	August	September	October	November	
<b>Financim i brendshëm</b>	<b>- 2,779</b>	<b>1,599</b>	<b>- 9,057</b>	<b>1,949</b>	<b>8,488</b>	<b>18,435</b>	<b>19,906</b>	<b>23,785</b>	<b>28,587</b>	<b>17,968</b>	<b>-72,398</b>	<b>Domestic financing</b>
Në %	138.3	321.0	-102.8	13.2	41.1	63.3	66.9	76.6	79.4	50.0	-219.5	In %
<b>Financim i huaj</b>	<b>770</b>	<b>- 1,101</b>	<b>17,871</b>	<b>12,867</b>	<b>12,181</b>	<b>10,706</b>	<b>9,850</b>	<b>7,274</b>	<b>7,407</b>	<b>17,937</b>	<b>105,381</b>	<b>Foreign financing</b>
